



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0263

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “E-Commerce - Kosova” SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “MINISTRIA E MBROJTJES” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së” me numër të prokurimit 217-24-4931-2-1-1, me 09/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë bazuar ankesa e OE “E-Commerce -Kosova” SH.P.K. me nr. 2025/0263, e datës 11/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së” me numër të prokurimit 217-24-4931-2-1-1.
2. Anulohet, B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “MINISTRIA E MBROJTJES”, aktiviteti i prokurimit “Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së” me numër të prokurimit 217-24-4931-2-1-1, ndërkaq lënda kthehet në Rivlersim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.05.2024, “MINISTRIA E MBROJTJES” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së” me nr. të prokurimit: 217-24-4931-2-1-1. Ndërsa me datën 26.03.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: , shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: Pjesa I :945,000.00 €.

Me 31.03.2025, OE “E-Commerce -Kosova” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 02.04.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11/04/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “E-Commerce -Kosova” SH.P.K me nr. 2025/0263 për lidhur me aktivitetin “Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së” me nr. të prokurimit: 217-24-4931-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “E-Commerce -Kosova” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Bazuar, në dispozitat 4 paragrafi 1.26, nenin 109 paragrafi 2, në plotëni të nenit 111 paraqesim Ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit

Në vijim do të paraqesim pretendimet tona ankimore

Pretendimi ankimore 1: Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues më datën 02.04.2025, e që në fakte kjo procedurë është duke u 'ripërsëritur tashmë tre herë me pretendimet e njëjta ku Autoriteti Kontraktues është duke anuluar procedurën me arsyetime të pa baza dhe në kundërshtim me dispozita primare të LPP-së dhe akteve sekondare.

Kronologji e aktivitetit, procedura në fazën e parë

Ankesa e paraqitur në Organin Shqyrtues të Prokurimit më datën 12.08.2024, ekspertiza e ekspertit profesional, vendimi organin shqyrtues të prokurimit numër 732/24 më datën 21.10.2024, të gjeturat e panelit shqyrtues:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "E-Commerce -Kosova" SH.P.K., me nr. 2024/0732, e datës 12/08/2024, kurse vendimi i AK "Ministria e Mbrojtjes" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së" me numër të prokurimit 217- 24-4931-2-1-1, kthehet në Rivlerësim sipas lotit i cili është atakuar me ankesë.

Provë: Vendimi Organit Shqyrtues të Prokurimit Nr. 2024/0732

Në ri-vlerësimin e ofertave sipas të gjeturave të PSH nr. 2024/0732 dhe rekomandimeve të ekspertit profesional lënda ishte kthyer në ri-vlerësim, rasti i parë autoriteti kontraktues kishte kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik oferta e së cilës ish dashur të shpallej e pa përgjegjshme që në vendimin e parë të AK. Kjo ofertë ishte renditur si OE i dytë (2) për nga çmimi, e njëjta ofertë ishte mbi vlerën e parashikuarë afërsisht dyzet mijë (40,000.00) euro.

Pasi, që OE pas kërkesës për sqarim dështoj të dëshmoj ligjshmëri të dokumenteve të saj autoriteti kontraktues kishte anuluar aktivitetin e prokurimit, sikur kjo ofertë do të mund të argumentonte Ligjshmërinë e saj si do ta trajtonte AK pasi që edhe kjo ofertë ishte mbi vlerën e zotuar të projektit. Ado të anulonte aktivitetin e prokurimit në mungesë të buxhetit.

Oferta jonë ishte e renditurë oferta e tret (3) duke qenë oferta e përgjegjshme me çmimin me të lirëz pas kërkesës për qasje në dokumentet e procedurës, komisioni për ri~ vlerësim të ofertave kishte rekomanduar ofertën tonë për kontratë.

Provë: Raporti komisionit ri-vlerësimin e ofertave i datës 20.11.2024

Autoriteti Kontraktues mori vendim për anulimin e procedurës në tersi duke dhen arsyet se të gjitha ofertat e përgjegjshme tejkalojnë vlerën e buxhetit të zotuar.

Provë: Vendimi Autoritetit Kontraktues më datën 22.11.2024

Duke mos u pajtuar me vendimin e autoritetit kontraktues në pajtim me dipozitat ligjore të LPP-së, neni 108/A zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, kemi kundërshtuar vendimin e AK për anulimin e procedurës duke paraqitur pretendimet tona të bazuara në dipozitat ligjore pasi që AK ka vepruar padrejtësisht me ofertën tonë duke cenuar rënd të drejtën tonë e bazuar në nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 4 Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose

imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik,

Provë: Kërkesa për qasje në dokumentet e procedurës më datën 23.11.2024

Provë: Kërkesa për ri-shqyrtim të vendimit të Autoritetit Kontraktues 26.11.2024

Pretendimi ankimore 2: Në pajtim të nenit 111 të LPP-së më datën 05.12.2024 kemi paraqitur pretendimet tona ankimore përmes ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit, më datën 26.12.2024 kemi pranur raportin e ekspertit profesional me rekomandimet që lënda të kthet në ri-vlerësim.

Provë: Raporti i ekspertit shqyrtues më datën 26.12.2024

Vendimi Organin Shqyrtues të Prokurimit numër 1185/24 më datën 14.02.2025, nga të gjeturat e panelit shqyrtues është vendosur që lënda prap të kthehet në ri-vlerësim.

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit "Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së" me numër të prokurimit 217-24-4931-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - "MINISTRIA E MBROJTJES" dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

Provë: Vendimi Organin Shqyrtues të Prokurimit numër 1185/24 më datën 14.02.2025

Autoriteti kontraktues pas dyzet ditësh (40) të ri-vlerësimit të ofertave më datën 26.03.2025 ka vendosur për anulimin e aktivitetit duke shkelur rënd parimet ligjore të LPP- së dhe Rregulloren për Prokurim Publikë Nr.001/2022 si: Nenin 9 paragrafi 3, nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do të ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Në dispozivin e vendimit të OSHP-së rënditurë numër tre (3) është citim:

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

Autoritetit Kontraktues i është dashur mbi dyzet ditë për të miratuar vendim për anulimin e procedurës sipas formularit B58 e që është në kundërshtim me afatet ligjore, sepse me nenin 59 dhe nenin 40, par 3 të Rregullores me nr. 001/2022, për prokurim publik për vlerësim të ofertave nuk mund të kaloni afatin prej më shumë se 30 ditëve, pavarësisht faktit se me vendim keni qene obliguar që ri vlerësimin ta realizoni për periudhën jo më shumë se 10 ditësh.

Mos zbatimi i vendimeve të OSHP-së, konsiderohet si shkelje e rendit ligjit për prokurim publik bazuar në nenin 97, të Rregullores me Nr. 001/2022, për Prokurim publik.

Më shqetësues është fakti se më datën 25.03.2025 ne kemi pranuar ftesë për procedurën e negociuar me emërtim (extrem emergjent) më të dhënat prokuruese titull Shërbimet për mirëmbajtjen e hapësirave të objekteve të FSK-së, numër të prokurimit 217-25-2248-2-1-

5. Në këtë projekt janë alokuar mjete buxhetore në shumë prej 215.000 euro, data e fundit për dorëzimin e ofertave 01.04.2025.

Një ditë para vendimit për anulimin e procedurës së rregullt Kontratë Kornizë të datë 26.03.2025, siç e cituam më lartë vlerën prej 215,000.00 euro e zotuar në procedurës emergjente do të ishin mjete (buxhet) të cilat do të plotësonin mungesën e buxhetit për kontratën kornizë për 36 muaj vlera e kërkuar për kontratën kornizë ishte 98,268.24 euro, nga ky buxhet të mbetëshin edhe 116,731.00 euro më shumë për AK. Andaj, vendimi AK- së është në kundërshtim me parimet bazë të LPP-së e më saktësisht neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, paragrafi 1 të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Datat e veprimeve të Autoritetit Kontraktues Ftesa për ofertim emergjent 25.03.2025.

- Anulimi i procedurës formularit B58 së rregullt për Kontratë Kornizë për tridhjetë e gjashtë muaj më datën 26.03.2025.

- Provë: Ftesa për ofertim emergjent, dhe vendimi AK-së për anulimin e procedurës formularit B58

Në planifikimet buxhetore (Plani Final i Prokurimit) për vitin 2025 në sistemin e-prokurimit për Autoritetin tuaj janë planifikuarë buxheti i tërësishëm për Kontratën Kornizë që është në vlerën buxhetore 1,310,000.00 (V1-360,000 V2-490,000, V3- 460,000) për 36 muaj kodi 93000000-8 të dhënat në emërtim: shërbimet e mirëmbajtjes e hapësirave të brendshme.

Andaj, arsyetimi i dhënë në njoftimin për vendimin AK-së, se mungon buxheti për vazhdimin e këtij aktiviteti nuk qëndron dhe se vendimi cenon rëndë të drejtat e parashikuara në dipozitat primare dhe sekondare të LPP-së.

Provë: Sistemi prokurimit (planifikimi final buxhetorë për vitin 2025 të AK-së)

Në raportin e komisionit për ri-vlerësimin e ofertave 26.03.2025 është rekomanduar oferta e kompanisë sonë për kontratë. Në komunikimet të cilat ne kemi kërkuar qasje në mes akteve brenda autoritetit tuj është thënë se (të anulohet ky aktivitet sepse janë shtuar objektet si Kazerma në Suharekë si dhe Kazerma në Dumosh). Ky arsyetim nuk qëndron sepse dipozitat ligjore thuhet se Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Edhe me ndryshimin e metrave të supozuara edhe numrin e punëtorëve higjienist vlera e lejuar në plus/minus tridhjetë përqind (30%) do të mundësonte që të mbulohen të gjitha kërkesat e

mundshme të autoritetit tuja. Si dhe kontrata kornizë është e rregulluar në aspektin e afatit të saj vetëm kur përfundon, si dhe kontratat kornizë mund të përfundojnë e para afatit përfundimtare në momentin e përfundimit të buxhetit të rregullt si dhe buxhetit që do të mud të shtohet në raste se do paraqitet nevoja për autoritetin. Si dhe "do të ishte privilegj i kompanisë dhe stafit të kompanisë që të ofroje shërbime në sa më shumë objekte dhe kazerma të reja për Forcën e Sigurisë së Kosovës".

Në kundërshtim me parimet procedurale lidhur me Kontratat Kornizë e cila është emëruar në FTD e të dhënave të dosjes pika numër 5.4 në të cilën është parashikuarë devijimi i mundshëm sipas nenit Neni 38 Kontratat Publike Kornizë paragrafi 2 ku është thënë se:

Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative.

Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqindje (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa marrë parasysh datën orifijnale të skadimit të Kontratës.

Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Provë: Raporti i komisionit për ri-vlerësimin të ofertave të datës 26.03.2025

Të nderuar, Panel Shqyrtues, Ekspert Profesional, autoriteti kontraktues edhe për kundër që lënda në fjalë është ri kthyer në ri-vlerësim me dy vendime të autoritetit tuaj, procedura tenderues zvarritet dhe anulohet padrejtësisht nga autoriteti kontraktues, me arsyetimet të cilat janë në kundërshtim të drejtpërdrejt me aktet primare dhe sekondare të prokurimit publikë sepse:

Nga dy raportet e vlerësimit të ofertave jemi rekomanduar për kontratë duke qenë oferta me çmimin me të lirë të përgjegjshëm.

- Ftesa për procedurë emergjente të negociuarë e datës 25.03.2025 bie në kundërshtim të vendimit të AK për anulimin e aktivitetit për shkak se gjysma e këtij aktiviteti do të mjaftonte për vazhdimin e procedurë për kontratën e rregullt.

Planifikimi buxhetorë për vitin 2025 i publikuar argumenton padrejtësinë e AK-së për ofertën e kompanisë sonë.

Bazuar në pretendimet tona ankimore dhe shkeljet e vazhdueshme të dispozitave nga AK: Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe Version i Konsoliduar i Rregullores për Prokurim Publikë nr.001/2022 kërkojmë nga Organi Shqyrtues i prokurimit të miratoj: Vendim

I. Aprovohet e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik E-commerce-Kosova Sh.p.k, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

II. Duke parë tendencën e vazhdueshme të autoritetit kontraktues e më saktësisht zyrtarit përgjegjës të prokurimit bazuar në kompetencat ligjore të Organit Shqyrtues të Prokurimit dispozitat e LPP-së nenin 105 dhe paragrafin 2.10 dhe 2.16 të lëshoj:

III. Urdhëresë për zbatim të vendimeve të OSHP-së numër Nr. 2024/0732,1185/24, pasi që elementet përmbajtësore të ankesës, dhe perëndimet ankimore janë të njëjta, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta ne pretendojmë se kjo çështje duhet konsideruar "RES JUDICATA sipas paragrafit 2.16 të LPP-së.

VI. Ti shqiptohet vërejtje Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në AK- "Ministria e Mbrojtjes " për mos zbatim të LPP-se dhe vendime të Organit Shqyrtues të Prokurimit, së ne te ardhmen nëse nuk zbatohen dispozitat e cituara ndaj të njëjtit do të iniciohet procedura për revokimin e certifikatës së prokurimit për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore në vazhdimësi.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "E-Commerce -Kosova" SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim eni 4 Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 1.2.3.4, Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, paragrafi 2 dhe 3, Neni 17 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 25 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, paragrafi 1, Neni 38 Kontratrat Publike Kornizë në paragrafin 2 të këtij neni është thënë se: , Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1.1, 001/2022 Rregullorja për Prokurim Publikë (verisioni i konsoliduar), Neni 4/paragrafi 4.3 pjesa nën c. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës, Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve , Interpretimin ligjore i dhe nga Krpp me datën 11.04.2024 Interpretimi ligjore i dhe nga Krpp me datën 29.03.2023.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: rup i OE E-Commerce -Kosova SH.P.K.; MBUROJA SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K., si palë e pakënaqur ka deponuar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të AK-MM me datë 01.04.2025, duke pretenduar se AK gjatë Ri-vlerësimit dhe krahasimit të ofertës dhe me anulimin e aktivitetit ka bërë shkelje të në neneve në vijim të Ligjit Nr. 04/042, LPP ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92: Neni 4 Paragrafi. 1.26. Palë e interesuar, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 1.2.3.4, Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur, paragrafi 2 dhe 3, Neni 17 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Shërbime, Neni 25 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, paragrafi 1, Neni 38 Kontratrat Publike Kornizë në paragrafin 2 të këtij neni është thënë se:, Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës paragrafi 1.1, 001/2022 Rregullorja për Prokurim Publikë (verisioni i konsoliduar) Interpretimin i Krpp-së të datës 11.04.2024.

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, AK, ka bërë ekzaminimin, Ri-vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të barabarte sepse Ri-vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe kërkesave të përcaktuar në dosjen të tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe Kriterit për Dhënien e Kontratës, Autoriteti kontraktues ka respektuar ne tersi Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L- 092.

AK/MM-se ka anuluar aktivitetin e prokurimit për shkak se të gjitha ofertat e përgjegjshme e kane tejkualuar buxhetin e planifikuar për këtë projekt. Grup i OE i rekomanduar për kontratë ka vlerën totale prej: 1,043,268.24 Euro, ose ne tejkualim mbi buxhetin e planifikuar ne vlere monetare prej 98,268.24 Euro apo/ përqindje afër 10.5% mbi buxhetin e planifikuar për projektin. Ky tejkualim e bën të pamundur përmbushjen e këtij projekti brenda buxhetit të

planifikuar, duke kërkuar kështu burime shtesë të cilat nuk janë të parashikuara.

Njoftim:

Për këtë projekt kane qene te planifikuar sipas Deklaratës se Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve Sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne totale për tre vite prej: 945.00,000.00 €

Ky aktiviteti i prokurimit ANULOHEM për shkak të Tejkalimi të Buxhetit të Planifikuar se të gjitha ofertat e përgjegjshme e kanë tejkaluar buxhetin e planifikuar. Pasi që kemi marr konfirmimin nga Njësia kërkuuese, ZKA se nuk kemi mjete shtese e për këtë projekt. Për arsye se FSK ka marrë në pronësi lokacione të reja si: kazerma në Suharekë, kazerma në Dumosh dhe gjithashtu janë bërë ndërtime të reja në vazhdimësi, pra janë shtuar dhe do të shtohen hapësirat (m2) për pastrim.

Andaj ky projekt do të kthehet për ri-plotësim të specifikacionit teknik, shtimit të hapësirave dhe rritjes së buxhetit nga buxheti i paraparë në këtë kërkesë. Pas ri plotësimit do të zhvillohen procedurat e ri tenderimit P.S.

Buxheti i planifikuar për këtë projekt sipas DDF është 945,000.006, ndërsa oferta e rekomanduar për dhënie të kontratës 1,043,268.246 shprehur ne vlere monetare 98,268.24,000.00 6 ose shprehur në 10.5 % mbi buxhetin e planifikuar.

Autoriteti Kontraktues/MM bazuar në konstatimet e cekura më lartë ka respektuar në tërësi dispozitat e legjislacionit në fuqi, për Prokurimin Publik andaj mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 26.03.2025. Andaj, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit AK/MM, duke u bazuar ne ato që u tha me lartë, vendosi si në dispozitivin të këtij vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.04.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0263/2025, ndërsa me datë 28.04.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0263/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtratat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtratat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante

lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “E-Commerce -Kosova” SH.P.K ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0263 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues: Pas shqyrtimit të këtij pretendimi, analizimit të shkresave të kësaj lënde të dokumentuara në platformën e-prokurimi, duke u mbështetur në LPP si ligj material dhe rregullat e prokurimit publik (RRPP), si dhe pasë kërkesës për sqarime drejtuar AK –së përmes platformës e-prokurimi më datë 24.04.2025, lidhur me dokumentimin për mungesë të mjeteve të konfirmuar nga ZKF dhe njësia kërkuese i njeiti nuk është përgjigjur edhe pse e ka pasurë të përcaktuar afatin për konfirmim të sqarimit , andaj ekspertit shqyrtues vlerëson se AK me aktet dhe veprimet e saj nuk i ka respektuar nenin 4 të LPP-së dhe nenin 8 të Rregullorës së Prokurimit Publik si dhe vendimet e panelit shqyrtues OSHP:2024/0133 dhe 2024/1185. Për më tepër ekspertit shqyrtues, konstaton se vendimet e OSHP-së janë përfundimtare/detyruese për palët dhe si të tilla i nënshtrohen kontrollit gjyqësor me mjete juridike bazuar në nenin 119 të LPP-së.

Në këtë kontekst, ekspertit shqyrtues duke vepruar në kuptim të nenit 16 paragrafit 2 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e njofton panelin shqyrtues se palët janë të njehta (AK-OE ankues) objekti i këtij pretendimi është i njejtë dhe është shqyrtuar më parë me vendimet nr. 2024/118 dhe 2024/0133, andaj për këto arsye, i propozon panelit shqyrtues që këtë çështje të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga ekspertit i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga ekspertit që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, për faktin se Paneli shqyrtues konstaton se në këtë aktivitet të prokurimit të cilën e ka iniciuar Autoriteti Kontraktues, “MINISTRIA E MBROJTJES”, ku edhe ka anuluar sipas arsyetimit në B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se, se të gjitha ofertat e përgjegjshme të dorëzuara kanë tejkaluar buxhetin e planifikuar për këtë projektë . PSH konsideron se nuk mund të anulohet një aktivitet derisa AK-ja përveq e-mailave nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme konfirmimin nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, Tabelën buxhetore se nuk ka mjete

dhe nuk ka mundësi bartje derisa kjo procedur hyn tek kategoria mallrat dhe shërbimet, dhe se nuk mund të bëhet levizja -destinimi i mjeteve kur dihet që tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve mund të bëhet, andaj PSH mbështet raportin e ekspertit shqyrtues ku ekspertit shqyrtues në raportë ka potencuar citoj “*dhe pasë kërkesës për sqarime drejtuar AK –së përmes platformës e-prokurimi më datë 24.04.2025, lidhur me dokumentimin për mungesë të mjeteve të konfirmuar nga ZKF dhe njësis kërkuese i njejt nuk është përgjigjur edhe pse e ka pasurë të përcaktuar afatin për konfirmim të sqarimit*”.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, mos përgjigjen e ofruar sipas sqarimeve të kërkuara nga eksperti shqyrtues drejtuar AK-se ka vendur që aktiviteti i prokurimit me “Shërbimet e Mirëmbajtjes Higjienike (Pastrimit) e ndarë në dy Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) për nevojat e FSK-së Pjesa 2 Shërbimet e Mirëmbajtjes higjienike (Pastrimit) në Ndërtesën e MM-së” me nr. të prokurimit: 217-24-4931-2-1-1, të anulohet B58 Njoftim mbi vendimin e AK-së ndërkaq lënda kthehet në Rivlersim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E MBROJTJES**
- **OE - " E-Commerce -Kosova " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: